



SBASHK Arsimimi sot

Shtator, 2023

Gazeta elektronike

SBASHK u takua me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Flanagan – SBASHK-u gëzon mbështetjen e fuqishme të ETUCE-s



Pasi kishin marrë pjesë në punimet e Kongresit zgjedhor të Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë në Tiranë, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala e koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan, të cilin e kanë informuar për aktualitetin në arsimin e Kosovës dhe për angazhimet në shërbim të anëtarësisë, por edhe për sfidat e shumta të kohës duke u fokusuar të qasja e gabueshme e ... (faqe 4)

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me kryetarin e Prishtinës Përparim Rama

Gatishmëri për dialog të sinqertë dhe angazhime të përbashkëta

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë ... (faqe 8)

Intervistë me drejtorin e programit të Qendrës së Solidaritetit për Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, z. Steven McCloud



... (faqe 3)

Takime me kryetarët e shoqatave sindikale
Respekt meritor për SBASHK-un dhe angazhimet në shërbim të anëtarësisë



Pas takimit me kryetarin... (faqe 4)

Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe SBASHK vazhdojnë me aktivitetet të përbashkëta

Përvoja të reja për përballje me sfidat e kohës



Me qëllim të forcimit të ... (faqe 6)



Editorial

Shtatori me shqetësimet për tekstet shkollor



Të gjithë po shpresonim se do ta kemi një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Disa prindër kishin bërë apel që të fillohet me procesin mësimor të hënën e 4 shtatorit, por ministria dëshmoi se vendimet i sjell vet e pa konsultime me të tjerët dhe nuk përfilli këto kërkesa. Viti shkollor nisi të premten e 1 shtatorit dhe plot debate që filluan në javën e fundit të gushtit për arsye të vendimit të gabuar të Ministrisë dhe zonjës Nagavci për tekstet shkollore. Ishte ky vendim i paqëlluar dhe i sjellë shumë me vonesë.

SBASHK-u, por edhe prindërit dhe individë e subjekte politike, shprehen reagimet e tyre dhe debati vazhdoi për ditë me radhë. Të gjithë e thanë se MASHTI ka vepruar gabim duke vendosur që tekstet shkollore për filloristët të shkonin në librari dhe prindërit duke pritur rimbursim mjjetesh do

t'i blinin ato. Për nxënësit nga klasët e gjashta e deri edhe në të nëntat u tha se duhet të mësojnë nga tekstet që janë përdorur në vitin e kaluar shkollor. Ditët e shtatorit po shkonin dhe koha dëshmoi se MASHTI ka gabuar sepse furnizimi i nxënësve me tekste shkollore po shoqërohej me shumë vështirësi dhe kjo bëri që ende të kishte numër të madh nxënësish pa tekste shkollore, situatë kjo që vështirësoi rrjedhën e vitit të ri shkollor.

SBASHK uron që Ministria ta ketë kuptuar se ka vepruar gabimisht dhe se në vitin e ardhshëm shkollor do të veprojë ashtu si duhet e në konsultim me palët që janë të ndërlidhura me arsimin dhe procesin mësimor.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimit SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me drejtorin e programit të Qendrës së Solidaritetit për Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, z.Steven McCloud



Arsimimi Sot:

Na thoni diçka nga biografia juaj.

McCloud:

Unë jam rritur në një familje punëtorësh në jug të Shteteve të Bashkuara. Pasi mbarova shkollën e mesme, punova si shofer, në dyqanet e

shitjes me pakicë dhe në ndërtim, ndërkohë që ndiqja universitetin. Diploma ime e ciklit të parë është në psikologji, kam edhe një master në studimet e punës. Para se të punoja për Qendrën e Solidaritetit, punova rreth 10 vjet për sindikatat kombëtare në Shtetet e Bashkuara. Në vitin 2020, u transferova në Beograd si Drejtor Vendor për programet e Qendrës së Solidaritetit në Serbi, Bosnje-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri. Në shtator 2021, u zhvendosa në Tiranë, Shqipëri për të hapur zyrën tonë të dytë në rajon, nga e cila punojmë në Shqipëri, Kosovë, dhe Maqedoninë e Veriut.

Arsimimi Sot:

Jeni shumë i përkushtuar për të ndihmuar sindikatat që të jenë zë i fuqishëm i anëtarësisë, cili është motivi juaj për këtë?

McCloud:

Kam parë sesi sindikatat e forta dhe të pavarura mund të kenë ndikim real për familjet punëtoresh. Në Shtetet e Bashkuara, kam punuar në fabrika që kishin sindikata të forta, kam punuar edhe në ato që kishin sindikata të dobëta, ose në fabrika që nuk kishin fare sindikata. Ndryshimi është i qartë. Sindikatat e forta bëjnë shumë më tepër sesa thjesht avokojnë për paga më të mira. Ato përmirësojnë sigurinë në vendin e punës, sigurojnë kushte cilësore pune dhe bëhen pengesë për diskriminimin dhe ngacmimin në punë.

Arsimimi Sot:

U gjendet rastësisht në angazhime të tilla për sindikatat, apo e keni traditë familjare sindikalizmin?

McCloud:

Familjarët e mi kanë qenë anëtarë të sindikatave prej tre brezash. Gjyshi im, babai, xhaxhallarët, vëllai dhe unë kemi qenë të gjithë anëtarë të të njëjtës sindikate të

ndërtimit. Familjarët e mi kanë qenë gjithmonë anëtarë aktivë, zakonisht si ata që ne i quajmë “kujdestarët e dyqaneve” (përfaqësues vullnetar i sindikatës në një kompani), por unë jam i pari në familjen time që u punësova në sindikatë.

Arsimimi Sot:

Cili është vlerësimi juaj për SBASHK-un?

McCloud:

SBASHK luan një rol jetësor në Kosovë. Nuk ka asgjë më të rëndësishme për shoqërinë sesa edukimi i popullit të saj. Sindikatat e arsimit mbrojnë jo vetëm anëtarët e tyre dhe mësuesit e tjerë, por ato bëjnë të mundur që arsimi publik me cilësi të lartë të jetë prioritet.

Arsimimi Sot:

Cilat janë disa nga përshtypjet që ruani nga bashkëpunimi me SBASHK-un dhe sindikatat tjera në shtetet e Ballkanit dhe në shtete të tjera?

McCloud:

Më kanë pëlqyer shumë aktivitetet tona me SBASHK. Anëtarët janë gjithmonë shumë të angazhuar në diskutime dhe shumë aktivë në seminarët tona. Sindikatat në rajon, si kudo, përballen me një luftë të vështirë. Sindikatat mund ta kenë vecanërisht të vështirë të shtrihen në sektorin privat. Negociimi i një kontrate me një kompani shumë-kombëshe mund të jetë shumë ndryshe krahasuar me negociimin e kontratës me qeverinë. Ndërsa pasuritë publike privatizohen, sindikatave mund t'u duhet të ndryshojnë strategjinë e tyre të negociimit dhe përfaqësimit të anëtarëve.

Një gjë që më vjen gjithmonë në mendje, lidhur me SBASHK-in apo ndonjë sindikatë tjetër në rajon, është se çështjet e sindikatave dhe punëtorëve këtu janë shumë të ngjashme me ato në Shtetet e Bashkuara. Mësuesit në Kosovë kanë probleme me ngarkesën mësimore, pajisjet jo të mjaftueshme në klasë dhe për fat të keq, ndonjëherë probleme me mungesën e respektit nga ana e prindërve dhe administratorëve. Këto janë të njëjtat çështje me të cilat përballen edhe mësuesit në SHBA.

Arsimimi Sot:

Në çka duhet të fokusohet më shumë SBASHK-u në të ardhmen?

McCloud:

Si të gjitha sindikatat, përfshirja e mësuesve në moshë

të re në sindikatë është shumë e rëndësishme. Sindikatat kanë probleme me zhvillimin e brezit të ardhshëm të udhëheqësve, por kjo është shumë e rëndësishme për të ardhmen. Gjithashtu, komunikimi me anëtarët është çelësi i suksesit. Në trajnimet tona të komunikimit me SBASHK, kemi thënë se komunikimi duhet të jetë i dyanshëm. Udhëheqësit duhet të komunikojnë prioritetet me anëtarët dhe anëtarësia duhet të jetë në komunikim të vazhdueshëm me udhëheqësit.

Arsimimi Sot:

Mesazhi juaj për stafin udhëheqës, për veprimtarët sindikalë dhe për anëtarësinë e SBASHK-ut.

McCloud:

Qendra e Solidaritetit është shumë e lumtur që po bashkëpunon sërish me sindikatat në Kosovë. Ne mendojmë se zyra jonë në Tiranë do të jetë e hapur për shumë vite dhe do të jemi rregullisht në Kosovë. Tashmë unë kam takuar kaq shumë njerëz të mrekullueshëm në Kosovë dhe mezi pres të takoj shumë të tjerë si ju në të ardhmen, në aktivitetet tona me SBASHK!

Gjatë muajit

SBASHK u takua me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Flanagan – SBASHK-u gëzon mbështetjen e fuqishme të ETUCE-s



Pasi kishin marrë pjesë në punimet e Kongresit zgjedhor të Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë në Tiranë, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala e koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan, të cilin e kanë informuar për aktualitetin në arsimin e Kosovës dhe për angazhimet në shërbim të anëtarësisë, por edhe për sfidat e shumta të kohës duke u fokusuar të qasja e gabueshme e Qeverisë ndaj sindikatave dhe të mungesa e dialogut me fajin e institucioneve qendrore të Kosovës. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kërkuar nga kryetari Flanagan që të

ngrit në organet e Unionit, që përfaqëson 11 milionë anëtarë, por edhe në institucione të tjera shqetësimin se Qeveria e Kosovës duke tërhequr vazhdimisht vëmendjen e opinionit me rrjedhën e dialogut me Serbinë, po vazhdon përpjekjet për shuarjen e zërit sindikal duke mos ndalur goditjet ndaj sindikatave dhe duke mohuar dialogun me to.

Kryetari Flanagan ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe është shprehur se ka shumë informacione për angazhimet dhe sfidat, informacione këto të cilat i ka marrë nga drejtorja e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Susan Flocken dhe se SBASHK ka pasur dhe ka mbështetjen e fuqishme të ETUCE-s në gjithë angazhimet për mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë dhe realizimit të kërkesave të tyre legjitime. Flanagan ka shprehur shqetësimin e tij dhe të Unionit që përfaqëson për qasjen e gabuar të Qeverisë së Kosovës ndaj sindikatave dhe dialogut dhe ka siguruar përfaqësuesit e SBASHK-ut se këto shqetësime do t'i prezantojë edhe në takimet e organeve të ETUCE-s në Bruksel, por edhe në institucionet ndërkombëtare që merren me dialogun social.

Takime me kryetarët e shoqatave sindikale

Respekt meritohet për SBASHK-un dhe angazhimet në shërbim të anëtarësisë

Pas takimit me kryetarin Bedri Hamza përfaqësuesit e SBASHK-ut janë gjendur në ambientet e shkollës “Asdreni”. Atyre u ka dëshiruar mirëseardhje drejtoresha e këtij institucioni të respektuar arsimor, Melihate Meha. Pas kësaj ka nisur takimi që u zhvillua në formë të bashkëbisedës për gjendjen aktuale në arsim dhe për angazhimet sindikale dhe detyrat konkrete për të ardhmen.



Në fillim të këtij takimi kryetari Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Isa Ismajli ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për pjesëmarrje në këtë takim dhe ka shpalosur disa nga aktivitetet sindikale në këtë komunë duke u ndalur edhe të sfidat, nga të cilat ka veçuar pengesat që hasen nga një numër i të punësuarve për regjistrim në e-Kosova. Kryetari Jasharaj ka përsëritur të pranishmit dhe pastaj ka treguar për disa nga aktivitetet e SBASHK-ut duke u ndalur edhe të problemi i krijuar nga vendimi i MASHTI-t për tekstet shkollore. Jasharaj ka lutur pjesëmarrësit që të përcjellin të punëtorët arsimor në Mitrovicë apelin që mos të bëhet as edhe një lloj presioni ndaj nxënësve që ende nuk janë pajisur me tekste shkollore, ngase nuk është faji i tyre. Në situatën e krijuar punëtorët arsimor nuk e kanë të lehtë, por mësimdhënësit janë dëshmuar gjithmonë se dinë të përballen me sfidat dhe t'i tejkalojnë ato suksesshëm.



Në pjesën e dytë të këtij koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e zyrtari ligjor Blendor Shatri u janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve.

Në fund të këtij takimi drejtoresha e shkollës “Asdreni” Melihate Meha i ka dorëzuar SBASHK-ut një dhuratë me motive nga lashtësia e qytetit të Mitrovicës në shenjë të respektit për angazhimet dhe përkushtimin gjatë gjithë këtyre viteve.

Kuvend pune në Viti

Pas takimit me kryetarin Sokol Haliti përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar me kryetarët e shoqatave sindikale në ambientet e shkollës profesionale “Jonuz Zejnullahu”.



Në hapje të këtij takimi të punës, kryetari i kuvendit sindikal për arsimin parauniversitar të Vitisë Kemajl Bislimi ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën dhe ka treguar për bashkëbisedën e zhvilluar me kryetarin e komunës z.Haliti. Ai pastaj ka kujtuar disa nga aktivitetet e zhvilluara sindikale në këtë komunë. Kryetari Jasharaj duke përsëritur pjesëmarrësit është shprehur i nderuar me takimin e zhvilluar me kryetarin z.Haliti dhe drejtoreshën znj.Ajeti për cka u jemi mirënjohës për zhvillim të suksesshëm të dialogut social në nivel lokal përkundër ngecjes së dialogut social në nivel qendror. Po ashtu kryetari Jasharaj është shprehur i nderuar edhe me takimin me koleget e kolegët sindikalistë nga shkollat e Vitisë. Ai ka apeluar te ta që ta përcjellin mesazhin te anëtarësia që të vazhdohet me unitet dhe që në situatën e rënduar që krijoi vendimi i MASHTI-t për tekstet shkollore të kenë qasje shumë pozitive ndaj nxënësve të cilët pa fajin e tyre ende vijnë në shkollë pa tekste shkollore.



Në këtë kuvend pune kryetarja e shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozhoran e ka ngritur shqetësimin e arsyeshëm për ambiente shumë të kufizuara pune e mësimi ngase ish ndërtesa e kësaj shkolle e dëmtuar rëndë nga tërmeti ka vite që nuk është ndërtuar dhe se fajtor për këtë është niveli qendror. Nxënësit e kësaj shkolle mësimet i zhvillojnë në ambientet e gjimnazit “Kongresi i Manastirit” dhe të dy këto institucione bashkë punojnë në katër ndërrime dhe si pasojë e kësaj është se orët e mësimi të pasdites janë vetëm 25 minuta, por edhe përkundër kësaj, siç tha kryetarja e kësaj shkolle mësimi po duhet të zhvillohet deri në orët e mbrëmjes, gjegjësisht deri në orën 20.

SBASHK-u apelon te MASHTI dhe institucionet tjera qendrore që të angazhohen maksimalisht në mënyrë që filloristët e shkollës “Halil Alidema” në Pozhoran sa më shpejt ta kenë shkollën e tyre për të zhvilluar procesin mësimor ashtu siç duhet, aq më shumë kur objekti shkollor kishte nisur të ndërtohet tani e katër vite më parë, por ka mbetur i pa përfunduar.

Në pjesën e dytë të këtij takimi të punës, nënkryetarja

e SBASHK-ut Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri u janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve që kishin të bënin me situatën aktuale dhe me aktivitetet që SBASHK-u do të zhvillojë në të ardhmen duke realizuar në përpikëri kërkesat e anëtarësisë.

Kuvend pune edhe në Gjakovë

Pas takimit me kryetarin e Gjakovës Ardina Gjini, përfaqësuesit e SBASHK-ut në ambientet e hotelit “Pashtriku” janë takuar me kryetaret e kryetarët e shoqatave sindikale të institucioneve arsimore të kësaj komune.



Në hapje të këtij takimi kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Zenun Nimani ka përshëndetur të pranishmit duke falënderuar

përfaqësuesit e nivelit qendror të SBASHK-ut për vizitën dhe pjesëmarrjen. Ai pastaj ka shpalosur disa nga aktivitetet sindikale që janë zhvilluar në këtë komunë. Kryetari Jasharaj ka përshëndetur të pranishmit duke i falënderuar për angazhimet dhe për unitetin e treguar në të gjitha situatat që janë shoqëruar edhe me shumë sfida, që janë tejkaluar suksesshëm falë përkushtimit, unitetit dhe besimit të ndërsjellë. Në pjesën e dytë të këtij takimi është zhvilluar bashkëbisedë e hapur dhe pyetjeve të pjesëmarrësve u janë përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e zyrtari ligjor Blendor Shatri.



Pjesëmarrësit kanë shprehur respekt meritore për angazhimet e kryetarit Jasharaj dhe stafit qendror duke u shprehur të sigurt se ky angazhim do të vazhdojë edhe në të ardhmen me moton Bashkë e në SBASHK.

Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe SBASHK vazhdojnë me aktivitete të përbashkëta Përvoja të reja për përballje me sfidat e kohës

Me qëllim të forcimit të zërit sindikal dhe përgatitjes së sindikatës sonë që të vazhdojë me përballje të suksesshme me sfidat e shumta të kohës, Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë vazhdon bashkëpunimin e frytshëm me SBASHK -un. Në kuadër të këtij bashkëpunimi Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe SBASHK po organizojnë punëtori tematike me temat kyçe për rëndësinë e organizimit sindikal dhe për rëndësinë pse duhet të jetë një punëtor arsimor anëtar i SBASHK-ut.



Ky aktivitet filloi më 22 shtator me veprimtarë sindikalë nga Universitetet dhe komunat e Prishtinës, Podujevës, Fushë Kosovës, Drenasit, Lipjanit e Obiliqit.



Në hapje të këtij aktiviteti kryetari i SBASHK -ut Rahman Jasharaj ka falënderuar z. Steven dhe zyrtarët Bruna dhe Kejsi. Jasharaj ka thënë se ky aktivitet do të përgatis kuadro sindikale që do të jenë zë i fuqishëm i SBASHK-ut duke mbrojtur të vërtetën e duke hedhur poshtë e me argumente ndonjë dezinformatë të qëllimshme të kujt do qoftë.

Drejtori rajonal i Qendrës Amerikane të Solidaritetit Steven McCloud ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet duke u shprehur se edhe në të ardhmen do të vazhdohet me bashkëpunimin dhe aktivitetet e

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

përbashkëta sindikale për ta forcuar edhe më shumë sindikalizmin dhe sindikatën.



Pas kësaj nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala ka treguar për strukturën dhe programin e SBASHK-ut dhe për rëndësinë për të qenë anëtar i sindikatës, kurse përfaqësuesja e Qendrës Amerikane e Solidaritetit, Bruna Hylviu ka prezantuar përvojat sindikale në shumë vende dhe për disa nga angazhimet konkrete që duhet të bëjnë sindikatat në shërbim të anëtarësisë e duke forcuar kështu zërin sindikal.



Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe puna në grupe e udhëhequr nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri me temën për strategjitë për rekrutimin e anëtarëve të ri.



Me tema e aktivitete të rëndësishme u vazhdua edhe në paraditen e së shtunës për të vazhduar ky aktivitet edhe në Mitrovicë.

Atmosferë uniteti e përkushtimi i veprimtarëve sindikal në Mitrovicë

Pas përfundimit me sukses të punëtorisë me temat kyçe për rëndësinë e organizimit sindikal dhe arsyet pse duhet të jemi anëtarë në SBASHK në Prishtinë me veprimtarë nga kryeqyteti dhe Podujeva, Fushë Kosova, Drenasi, Obiliqi e Lipjani, Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe

SBASHK-u kanë vazhduar këtë aktivitet të veçantë me veprimtarët sindikalë nga Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Zveçani e Leposaviqi.



Në hapje të këtij aktiviteti sindikal në Mitrovicë drejtori rajonal i Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud ka treguar për aktivitetet mbështetëse të kësaj Qendre kudo në botë, pra edhe në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut e në shtete tjera të Ballkanit. Ai ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet e përkushtimin në shërbim të anëtarësisë duke shtuar se edhe ky aktivitet është vazhdimësi e bashkëpunimit, i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim që të forcojmë edhe më shumë zërin sindikal.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka përshëndetur pjesëmarrësit e këtij aktiviteti duke falënderuar në emër të tyre drejtorin rajonal të Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud dhe zyrtaret Bruna e Kejsi për gjithë angazhimet në shërbim të forcimit të sindikatave të arsimit dhe në forcimin e bashkëpunimit me sindikatat simotra në Ballkan dhe me Sindikatën e Mësuesve të Amerikës, sindikatë kjo që ishte dhe mbetet mike dhe përkrahëse e madhe e SBASHK-ut.



Pas kësaj nënkryetarja e SBASHK -ut Vjollca Shala ka bërë një prezantim përmbajtësor lidhur me strukturën dhe programet e sindikatës sonë, ndërsa përfaqësuesja





e Qendrës Amerikane e Solidaritetit, Bruna Hylviu ka prezantuar çështje të ndërlidhura me aktivitetet, arritjet, por edhe sfidat e kohës. Ajo i ka dhënë theks të veçantë

unitetit dhe faktit se individi nuk është sindikata, po të gjithë anëtarët e saj dhe se sa më unik që janë ata, aq më i fuqishëm është zëri i tyre.

Pas këtyre prezantimeve është zhvilluar një bashkëbisedë e pjesëmarrësve me znj. Vjollca e Bruna.

Në vazhdim të këtij aktiviteti koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri ka udhëhequr punën në grupe lidhur me strategjitë që duhet vënë në veprim për rekrutimin e anëtarëve të rinj.

Ky aktivitet ka vazhduar edhe të dielën me prezantime të tjera që ndërlidhën me temat kyçe për rëndësinë e organizimit dhe forcimit të zërit sindikal.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut u takuan me kryetarin e Prishtinës Përparim Rama **Gatishmëri për dialog të sinqertë dhe angazhime të përbashkëta**



prindërve, mësimeve dhe nxënësve ka ndodhur me një ritëm shumë të ngadalshëm. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri i ka treguar kryetarit Rama për shumë nga aktivitetet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë. Ai pastaj ka shprehur gatishmërinë për të vazhduar me dialogun e sinqertë dhe bashkëpunimin e përbashkëta në shërbim të arsimit në kryeqytet.

Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën Ahmet Pillana është shprehur

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe Kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën Ahmet Pillana janë takuar me kryetarin kryeqytetit të Kosovës, z. Përparim Rama dhe shefin e kabinetit Vllaznim Osmani.

Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj ka përgëzuar kryetarin e Prishtinës për gjithë angazhimet në shërbim të qytetarëve dhe për bashkëpunimin e tij e të Drejtorisë së Arsimit me SBASHK-un në përpjekjet e përbashkëta në shërbim të arsimit dhe të realizimit të kërkesave të anëtarësisë. Kryetari i SBASHK-ut ka deklaruar se kemi pasur pritje se ky vit shkollor do të fillojë mbarë, por vendimi i gabuar i MASHTI-t lidhur me tekstet shkollore krijoi probleme të theksuara gjatë gjithë muajit shtator ngase furnizimi me tekste shkollore pa fajin e

se bashkëpunimi me DKA-në e Prishtinës është në nivel dhe se kështu do të vazhdohet edhe në të ardhmen sepse kur ka dialog e bashkëpunim të sinqertë, atëherë nuk mungojnë as angazhimet e përbashkëta e të suksesshme për të realizuar misionin e shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave.

Kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut si zë i fuqishëm i punëtorëve arsimor dhe ka treguar për gatishmërinë e tij e të gjithë institucioneve komunale për të vazhduar me bashkëpunimin dhe angazhimet e përbashkëta në shërbim të arsimit. Ai ka përmendur edhe angazhimet që përmes mjeteve bashkëkohore të punës mësimi të bëhet më atraktiv dhe më i lehtë për nxënësit duke ndihmuar kështu edhe në ngritjen e cilësisë në arsim.

Një aktivitet i veçantë i SBASHK-ut në disa komuna të Kosovës

Takime të ndara me kryetarët Bedri Hamza, Sokol Haliti e Ardian Gjini

Kryetari i SBASHK-ut bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri kanë filluar realizimin e agjendës së vizitave në komunat e Kosovës. Ata të enjten e 7 shtatorit kanë shkuar në Mitrovicë dhe të shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Isa Ismajli kanë vizituar Kuvendin Komunal dhe janë takuar me kryetarin Bedri Hamza.



Duke u dëshiruar mirëseardhje mysafirëve kryetari Hamza ka shprehur respekt për gjithë përkushtimin dhe angazhimet e SBASHK në shërbim të arsimit dhe realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë. Ai ka vlerësuar edhe bashkëpunimin korrekt me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Isa Ismajli dhe me veprimtarët tjerë sindikalë në përpjekjet e përbashkëta për rrugëtimin e mbarë të arsimit në këtë komunë.



Kryetari Hamza është shprehur se në angazhimet e tij vend meritore ka arsimit dhe pastaj ka informuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për gjithë angazhimet e investimet e bëra me qëllim që të krijohen kushte sa më të mira pune në institucionet arsimore të Mitrovicës. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë treguar për angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe janë ndalur edhe te problemi i krijuar me tekstet shkollore si pasojë e një vendimi të gabuar të MASHTI-t duke vlerësuar se kjo ka bërë që fillimi i

këtij viti shkollor të nis me vështirësi të theksuara për shkak të vështirësive që prindërit kanë që të furnizojnë fëmijët e tyre me tekste shkollore dhe nga fakti tjetër se tekstet shkollore për klasat 6-9 të përdorura vitin e kaluar shkollor janë të dëmtuara, por edhe vërehet një mungesë e theksuar e tyre. Të dy palët janë shprehur se do të vazhdojnë me bashkëpunimin dhe do ta pasurojnë dialogun për të kontribuar në rrjedhën e mbarë të arsimit në këtë komunë.

Duke vazhduar me agjendën e vizitave nëpër komunat e Kosovës, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatoren Ymer Ymeri, kanë vizituar komunën e Vitisë.



Ata fillimisht janë takuar me kryetarin e Kuvendit të sindikatës të arsimit parauniversitar në këtë komunë Kemjal Bislmi dhe nënkryetaren Makfirete Zuka për të shkuar bashkërisht në takim me kryetarin e komunës Sokol Haliti dhe drejtoreshën e arsimit Arta Ajeti.

Kryetari Haliti ka shprehur respekt meritore për angazhimet maksimale të SBASHK--ut nëpër vite për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. Ai ka lavdëruar bashkëpunimin korrekt me kryetarin Bislmi dhe përfaqësues tjerë të sindikatës sonë në këtë komunë. Kryetari Haliti ka informuar mysafirët për angazhimet e shumta që ai dhe institucionet komunale në Viti kanë bërë për përmirësimin e kushteve të punës në shumë nga institucionet arsimore në Viti, duke përmendur shembuj konkret të investimeve të bëra nga komuna.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar kryetarin Haliti për angazhimet e tij dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm e korrekt me sindikatën duke e përgëzuar edhe për gjithë ato investime të bëra për institucionet arsimore. Po ashtu përfaqësuesit e SBASHK-ut janë shprehur të bindur se ky bashkëpunim dhe dialogu i frytshëm social mes të dy palëve do të vazhdojë edhe në të ardhmen në shërbim të arsimit dhe të personelit arsimor në Viti.

Drejtoresha e arsimit Arta Ajeti në bashkëbisedë me përfaqësuesit e SBASHK-ut ka treguar për shumë aktivitete të përbashkëta dhe ka falënderuar SBASHK-un për numrin e madh të trajnimeve me punëtorët arsimor, trajnime këto që kanë ndihmuar në ngritjen e cilësisë në arsim.

Në vazhdim të agjendës së vizitave nëpër komunat e Kosovës kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri kanë vizituar komunën e Gjakovës. Ata fillimisht janë takuar me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Zenun Nimani dhe nënkryetaren Mirdita Ademaj e pastaj janë takuar me kryetarin komunës Ardian Gjini dhe drejtoreshën e arsimit Eranda Kumnova Baçi.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë falënderuar kryetarin Gjini për takimin dhe për bashkëpunimin duke i shprehur respekt meritore edhe për qëndrimin korrekt ndaj angazhimeve dhe veprimeve sindikale. Kryetari i Gjakovës ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut duke veçuar se institucionet vazhdimisht duhet të kenë komunikim dhe dialog të sinqertë me sindikatat në përpjekje për të gjetur zgjedhje të pranueshme për të gjitha kërkesat legjitime. Kryetari Gjini dhe drejtoresha Kumnova Baçi kanë lavdëruar angazhimet e kryetarit Nimani dhe të kryesisë duke u shprehur të gatshëm për angazhime të përbashkëta në shërbim të arsimit dhe të zgjedhjes së kërkesave të anëtarësisë brenda mundësive.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut do të vazhdojnë me realizimin e e agjendës së takimeve me kryetarët e komunave të Kosovës.

SBASHK në Kongresin e Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë **Shumë nga qeveritë nuk duan që sindikatat të jenë të forta**

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë ka mbajtur në Tiranë Kongresin zgjedhor. Në këtë ngjarje të veçantë për SPASH-in dhe arsimin e Shqipërisë, krahas delegateve e delegatëve, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe të shumë sindikatave të arsimit nga shtetet e Ballkanit dhe të Evropës.



Në hapje të punimeve të Kongresit kryetari i SPASH-it Nevruz Kaptelli ka shprehur kënaqësinë që në këtë ngjarje të veçantë po marrin pjesë edhe kryetari i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Larry Flanagan dhe përfaqësues të sindikatave të arsimit nga shumë vende

mike të Shqipërisë. Ai pastaj ka bërë një shpalosje të aktiviteteve të kësaj sindikate në shërbim të anëtarësisë e duke u ndalur edhe te nënshkrimi i Kontratës Kolektive të Arsimit për ta vlerësuar këtë si njërën nga arritjet e mëdha të SPASH-it.



Kryetari i Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Larry Flanagan ka sjellë në Tiranë përshëndetjet e miliona anëtarëve nga e tërë Evropa për kolegët dhe kolegët e tyre në Shqipëri duke theksuar se në këto kohë sfidash bashkëpunimi dhe solidariteti kanë rëndësi të madhe në rrugëtimin sindikal për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. Kongresin me fjalë rasti e kanë

përshëndetur edhe përfaqësuesit e sindikatave të tjera mysafire duke treguar për situatën aktuale në arsim dhe për aktivitetet sindikale në shtetet e tyre.



Në fjalën përshëndetëse kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj është shprehur se nga takimet me kolegët këtu vërehet se shumë nga qeveritë nuk duan që të ketë sindikata të forta dhe prandaj është shumë i nevojshëm bashkëpunimi dhe solidariteti mes sindikatave në gjithë shtetet e botës. Jasharaj pastaj duke i dëshiruar rrjedhë të mbarë

Kongresit ka thënë: “Një njeri i madh i kombit tonë ka thënë se unë jam mirë kur Shqipëria është mirë e unë si

njeri i thjeshtë, por edhe si sindikalist me përvojë, po them se SBASHK-u është mirë kur sindikata e arsimit të Shqipërisë është e fortë dhe arrinë suksese të shumta në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Ju jeni të tillë”, ka përfunduar përshëndetjen kryetari Jasharaj.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë zhvilluar takime të ndara me përfaqësues të sindikatës së Sllovenisë dhe të sindikatave të tjera dhe që të gjithë janë shprehur të gatshëm për të vazhduar bashkëpunimin e takimet me qëllim të përcjelljes së përvojave sindikale.

Olive Medical Group dhe SBASHK vazhdojnë bashkëpunimin Zbritje prej 20% të shërbimeve për anëtarët e SBASHK dhe familjarët e ngushtë të tyre

Institucioni i njohur shëndetësor “Olive MEDICAL Group” SH.P.K. duke shprehur respekt për punëtorët e arsimit dhe ndaj SBASHK-ut si zë i tyre, ka shprehur vullnetin që të vazhdohet bashkëpunimi duke nënshkruar Memorandum mirëkuptimi. Përfaqësuesja e këtij institucioni shëndetësor ka vizituar selinë e SBASHK-ut dhe fillimisht i ka uruar për fillimin e vitit të ri shkollor e pastaj ka shprehur respekt meritore për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Ajo ka vlerësuar se bashkëpunimi në të kaluarën ka qenë në nivel të lartë dhe ka lavdëruar anëtarët e SBASHK-ut për sjelljet me dinjitet sa herë kanë qenë në këtë institucion shëndetësor për të marrë shërbime.



Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë falënderuar këtë institucion shëndetësor për bashkëpunimin dhe respektin e treguar ndaj anëtarësisë së SBASHK-ut dhe për vullnetin që bashkëpunimi të vazhdojë.

Në Memorandumin e bashkëpunimit saktësohet se ky institucion shëndetësor ofron zbritje prej 20 % për të gjitha shërbimet shëndetësore për anëtarët e SBASHK-ut dhe pjesëtarët e familjes së ngushtë të tyre.



Ky institucion shëndetësor, përveç në Prishtinë, është i pranishëm edhe në Prizren, Mitrovicë, Gjiilan dhe Suharekë dhe ky Memorandum mirëkuptimi vlen edhe për Olive Medical Group në këto komuna.